

Gangjel Dalani

BIBLIOTEKA
SHTETIT

81H-1
D 18

RRUGA PER TE ZEMRAT

DODI

814-1
D16

VANGJEL DALANI

RRUGA PËR TE ZEMRAT

poezi

Mbledhur nga Çapajev Gjokutaj



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

PARATHÉNIE

Vangjel N. Dalani lindi në fshatin Livadhja të Sarandës, në vitin 1953, ku kreu edhe arsimin 8-vjeçar. Mësimet e shkollës së mesme i vazhdoi në Konispol, pastaj vazhdoi studimet në degën gjuhë-letërsi të Fakultetit Histori-Filologji. Në janar 1976, disa muaj para se të përfundonte fakultetin, vdiq.

Qysh fëmijë ai filloj të botonte vjersha e skica në gazeten «Pionieri» e më vonë në gazeten «Fitorja». Gjatë viteve të studimeve në fakultet, emri i tij u duk në organet qëndrore letrare.

* * *

Vjershat e përbledhura në këtë vëllim me titull «Rruga për te zemrat» janë shprehje e një talenti të vërtetë poetik. Po para kësaj është shprehje e dashurisë së madhe që ai ka pasur për letërsinë, e punës këmbëngulëse që ka bërë qysh në moshë të re, ende pionier, për të ardhur në këto krijime, që ka sot lexuesi në dorë, pjesën më të madhe të të cilave nuk mund të mos i rilexojë që të provojë disa herë kënaqësinë që të jep çdo krijim i arrirë ideoartistikisht.

Megjithëse Vangjel Dalani prej vitesh ka shkruar vjersha e krijime të llojeve të tjera, poezitë e këtij libri janë të dy-tre vjetëve të fundit, pra kur ka qenë student.

Vëllimi, edhe pse modest në numrin e vjershave, ka originalitetin, ka freskinë dhe hovet, herë-herë të drojtura po të bukura, të një të riu të talentuar. Dhe ky i ri është lidhur me problemet shoqërore, pa të cilat frysmezimi nuk do të kishte vlerë.

Tërësia e vjershave të jep idenë e plotë të poetit që sapo hedh hapat e para. Dhe këto hapa janë të sigurtë, të kumbueshëm e që lenë gjurmë. Të sigurtë sepse atij zemra i këndon natyrshëm, sepse ai poezinë di ta gjejë në jetë, në problematikën shoqërore, në botën e njeriut të punës. Të sigurtë sepse idetë dhe konceptimin artistik të tyre i ka origjinale e të qarta.

Duke kërkuar poezinë ai thellohet në dukuritë dhe

problemet e jetës, në psikologjinë e njeriut dhe fillon të meditojë shtruar për to. E, me sa duket, gjëja e parë që shikon te njerëzit e vendit të tij socialist është optimizmi dhe lumburia që përshkon ata. Të dyja këto do të shkrihen në konceptimin e mjafit vjershave, të cilat do të janë si lajmotiv apo pikënisje e tyre. Kështu, për shembull vjershat për fshatin nuk janë ekzotike, po mishërim i mendimeve e ndjenjave më të mira që ushqen autori për kooperativistin, për punën, idelet, fisnikërinë dhe thjeshtësinë e tij.

Këto, si dhe natyra aq lirike e vjershave të tij, mprehëtësia e të depërtuarit në dukuritë shoqërore, në zbulimin e anëve poetike, aftësia e të shprehurit artistik të pacunguar tregojnë se ai kishte arritur një shkallë të mirë në zhvillimin e tij si letrar.

Poezia e këtij autori të ri është e toneve delikate, e momenteve emocionante, e gërshtimit harmonik të idesë me ndjenjën po dhe e një harmonie që të bie në sy e të prek estetikisht, shumë herë pa e kuptuar aty për aty pse. Poezia e Vangjel Dalanit është e figurshme, sepse e tillë vjen që nga konceptimi i idesë. Dhe ky konceptim është i drejtë, i qartë, brenda natyrës së tij lirike. Duke e konceptuar idenë poetikisht, autori e kuption se edhe figurat, me të cilat do të shprehë mendime të veçanta të kësaj ideje, duhet të janë po aq organike e të vetvetishme sa edhe mendimet që burojnë prej fryshtimit. Dhe të kujtohen tek lexon e mendon për vjershat e tij, hartime origjinale, mendimet e disiplinuara e serioze që kishte në to, edhe

pse jo rrallëherë u mungonte figuracioni që duhej të kishin hartimet e një poeti në embrion.

Vangjeli është dashuronte folklorin, në kuptimin e plotë të kësaj fjale, e studjonte atë sistematikisht dhe mësonte përmendësh qysh në shkollë të mesme e akoma më tepër në Universitet. Por ai edhe dinte të përvetësonte prej krijimtarisë populllore. Prandaj shohim që lirizmi i tij spontan, ana kryesore e talentit të tij, në rastet më të qëlluara, shprehet me bukurinë dhe thjeshtësinë e lirikave populllore, apo të kujton gjuhën poetike, qartësinë dhe befasinë e figurës së klasikut *De Radë*. Puna që bënte poeti i ri për përvetësimin e folklorit nuk duket vetëm në këtë zotërim mjeshtëror. Ajo duket edhe në mënyrën e konceptimit të mjast ideve, në përpunimin e motiveve të folklorit përmes të cilëve kërkon të ndryjë ide të reja. Për këtë dëshmojnë edhe shënimet e tij, ku vjersha të tëra përpunojen në disa variante sipas mënyrës poetike populllore ose janë motive të marra direkt prej folklorit.

Nuk është e lehtë dhe as nuk e ndeshim dendur, ndër autorët e rinj, një të shprehur poetik kaq të goditur, të qartë e me një lirizëm të tillë spontan: sytë e nënës/ dhe gjithë shtëpia/ sonte u mbushën me mua./ («Kthim në shtëpi»); Në oborrin tim kam një portokalle/ që e porosita të bëjë kokrra shumë/ dhe t'i fshehë mes gjetesh, asnje mos t'i shohë,/ për atë që dua të këput ca unë/ («Nëna nuk e di»). Dhe akoma më i bukur: Fëmijët e vëgjël e duan një flutur/ për krahët me ngjyra, për krahët e bukur. Po unë s'jam i vogël, po unë s'jam fë-

mijë/ tē dehem nga ngjyrat, pas teje tē vij. («Po unë s'jam fëmijë»).

Nga vjershat del se poeti i ri jo vetëm kishte hove poetike në veten e tij, që vinin nga lidhja shpirtërore e autorit me realitetin shoqëror, por ai kishte edhe koncepte tē sakta mbi poezinë, për tē bukurën, për letërsinë e partishme. Ai ka qenë i ndërgjegjshëm si për rrugën e vështirë që kalon letrari ashtu edhe për nivelin e ngritur me tē cilin duhet t'i paraqitet poezia lexuesit. Prandaj Vangjeli punonte e shkruante shumë, botonte pak dhe i çonte vjershat në redaksi me drojtjen e njeriut që mund tē turpërohet me to.

Mund tē themi se, poeti i ri Vangjel Dalani pavarësisht se ishte në fillimet e krijimeve tē tij, kishte gjetur rrugën e vërtetë për në zemrat e njerëzve.

BASHKIM KUÇUKU

URIM PËR 1976!

Këtë vit qofshin më të lumtur
të gjithë sa kanë të nesërmën në sy!

Arat sjellshin bukë më tepër,
malet më shumë minerale
dhe më shumë gjelbërim.
Bagëtia sjelltë qumësht më boll
dhe bletët me mjaltë t'i mbushin kosheret.


Nuset bëfshin fëmijë të çiltër
me nga një emër shqiptar, të bukur si vetja;
qoftë i këndshëm tallazi i çarçafit të bardhë
mbi djepet e tyre
kur ta ngrejë e ta ulë frymëmarrja!

Lulëzofshin më shumëngjyrshëm lëndinat
dhe zemrat e njerëzve tanë!

Rëndofshin degët e pemëve nga frutat
dhe vogëlushët nga ëndërrat e shumta
dhe poetët nga vargjet «bombë e flamur»
dhe planët mujore nga arritjet.


Nxënësit marrshin dije më të hollë,
studentët më të rënda i paçin valixhet!
Syri i pushkës u bëftë më i mprehtë.

Era e pranverës haptë mbi glob
më shumë dritare e dyer shtëpish
e ndriçoftë në to komunizmi si diell!



PARA PARTISÉ

Çdo mendim,
çdo ëndërr,
çdo dëshirë
na hapet para teje,
si lulja para diellit,
Parti.



NË SEZONIN E PROVIMEVE

Në këtë dhomë
 qerpiqët e shokëve
 vonë i puth gjumi.
 Zhurma e shfletimit
 këtu është e vetmja,
 ka diçka nga çelja e luleve
 heshtja...

Naimi me vërgjet si fyej të ëmbël
 e vë Flamurin në gjumë,
 e bukura¹⁾ Fredit qepallat ia ul,
 Çimi fik dritat e fundit.
 Bujarin e zgjon një varg i Majakovskit
 dhe gjumi i ikën, më gjumi s'e zë.

1) e bukura — kategori estetike.

Ka një pranverë të vogël në dhomë,
një pranverë shqetësimi dhe ankthi,
një pranverë që në gjirin e tyre mbajnë
këto ditë
dhe net janari...

Pema ka ankth kur pret gjelbërimin
dhe fshatari kur gruri do korru
dhe punëtori kur bëhet bilanci
dhe studenti para provimit...

SHIU NË MAJ, SI VAJ!

Pardje ra shi.

Dje

ra shi përsëri

dhe sot gjithë ditën s'pushoi.

Tri ditë që s'doli shëtitje Edmondi,
tri ditë që buzët kafshon nga inati,
tri ditë pa qejf ky shoku im i dhomës,
mua mendja më vete nga fshati.

Janë ditë maji. Të mbjellat në fushë
të etura kthjenë nga një gllënjkë ujë...

Pijnë dhe rriten.

Pijnë dhe piqen.

Bukë do sjellin më shumë.

Do sjellin perime.

Dhe rrush do sjellin hardhitë
me kokrra sa kokërr e ullirit;
në mensën «Studenti»

ushqime më boll do të ketë.
Unë e kuptoj mërzinë e Edmondit
po thellë në shpirt kam tjetër ndiesi,
fjalët e gjyshit më vijnë që larg;
«Shiu në maj,
si vaj!»

Ytak 3: ob Hod ëm enjofshu
liberuan. I po ë, jaxhen lomqua e ëm i
berjatë zëvëndë me qëndra këtë përfshirje, që
lëvizet nga vëllai ëm tash që është e vlefshë
dhe qëndra këtë përfshirje është e vlefshë.

KTHIM NË SHTËPI

Vëllai i vogël rendi në oborr
m'u hodh në qafë,
rrëmbeu valixhen.

«Erdhi, erdhi!», thirri që larg,
dolën te dera
buzagaz të gjithë.

Babai më pa drejt e në sy,
gjithçka ma tha
me një shtrëngim të dorës,

Më ranë në fytyrë,
si kallëza gruri,
të bukurat flokë të motrës.

Erdha që larg
përsëri në shtëpi
ku çdo gjë më do dhe e dua.

Sytë e nënës
dhe gjithë shtëpia
sonte u mbushën me mua.

Pasnesër do nisem,
do më thonë mirupafshim
rrugët, ullintjtë, shtëpia.

Do më përcjellë shtëpia e vogël,
do më presë ngrohtë
e madhja, Shqipëria.



DUKE PARË VALLEN E SHQIPONJAVE


Pa ndaleni pak vallen, o valltarë,
t'ju bëj një pyetje unë, biri juaj.

Si mundët ju, shqiponja krahëlehta,
të mblidhni e të shkrini në një valle
gjithë shpirtin, vrullin, gjithë filozofinë
dhe karakterin e popullit ndër vargje?

Si ju ka çarë populli stuhive.
Pushtimet, hallet — flatrat ia rëndonin
por ai çau, qoftë dhe krahëpërgjakur
përpara drejt lirisë dhe lartësive.

Kaptoi dallgë, furtuna, horizonte,
dëborëra dhe stinë gjersa mbërriti
në pranverën tonë që ia bëri
dhe më të madhërishëm fluturimin.

Pa ndaleni pak vallen, o valltarë,
të marr dhe unë pak nga hovi juaj!



NË KOMBINATIN MATALURGJIK

Këtu çdo gjë lëviz e transformohet,
këtu asgjë nuk hesht, asgjë nuk flë,
diku një furrnaltë lartësohet
diku hapen themele, linjë e re!

Lëvizin njerëzit të shkathët e të hekurt,
lëviz nëntoka, toka dhe makinat,
zhurma tremb zogun që rri diku i fshehur,
kriku lëviz e shkojnë më tutje shinat.

Kupa e qiellit si me fishekzare
netve spërkatet nga saldimet
dhe ke ndjesinë se ka një festë të madhe
në Bradasheshin gjithë vezullime.

NJË DITË

Zemra ime, si çdo zemër tjetër,
një ditë, si orë e lodhur,
do të heshtë...
Po deri në sekondën e fundit
e ndezur për Partinë
do të jetë.

G J U M I I M

Sytë m'i mbyllin
dy pyetje të ëmbla:
«Si doli brigada?»
dhe «Ç'punë bëra sot?»

* * *

Megjithëse ka njerëz
që flenë mbi pupla
pa një cicërimë
andralle në tru,
gjumin s'e kanë
të këndshëm si unë.


KRENARI USHTARAKE

Më të mira, më të larta
vallë malet pse më duken?
Më të blerta, më pjellore
vallë fushat pse më ngajnjë?
Pse tani si Milo Shini
(kur po ngjitem nëpër shpatë)
më pëlqen të pyes ujvarat:
«Sa më bën vallë zemra mua?»
Malet, fushat, begatia,
bukuria e vendit tim
sot më kanë ushtar të tyre,
më kanë syrin vigjilent.
Ndaj duke gurgulluar
sot ujvarat më përgjigjen:
«Zemra jote rrëh për nëntë
me nëntëqind ajo lufton.»

SHPESH BURISË I BIE KY SHOFER...

Ka ca kohë që erdhi nga ushtria,
ka ca ditë që mori një kamion,
ndaj atë, çdo mëngjes e mbrëmje
do ta gjesh me duar në timon.

Shpesh burisë i bie ky shofer,
arave me grurë, kur kalon,
se diku, në një parcelë tek korr,
vajzë e zemrës ndoshta e dëgjon.



MOTIV NGA FOLKLORI

E morën plumbat në bark
dhe i dolën plaçkat jashtë.

Plaçkat i mbajti me dorë
...dy-tri hapa nëpër borë.


Hodhi dhe dy-tri granata,
shokët po i shkonin prapa.

U tha: «Shokë, do të vdes
gjaknë ta bëni gjer në brez!

Shokë, do të vdes po ju
gjaknë ta bëni gjer mbi gju!»

Plaçkat mbajti me dorë
edhe fjeti mbi dëborë.

Bora shtresë dhe jorgan,
fjeti qetë një partizan.




FUND TETORI

Mbi pemë bie krahu i erës,
të verdhat gjethë i këput
dhe shtron pastaj mbi trotuare
një sixhade të butë, të butë...

Kjo sixhade — trishtim i vjeshtës,
trishtim i ëmbël për çudi,
më ngjan se i thërret pranverës
që të buisë përsëri.

Shikoj pemët gjithë zhveshur
që presin tjetër gjelbërim
dhe plot lirika, èndërrime
plot jetë mbushet shpirti im.



«JAM SHUMË MIRË, JAM I LUMTUR!»

Baladë kushtuar shokut tim të
shkollës së mesme, mësuesit hero,
Ilia N. Qiqit.

Telegrami yt
ikte për në Jug
ti për në Veri
ecje nëpër muzg.

Telegrami yt
si një kartolinë
nëna e lexon,
puth fotografinë.

E lexon babai
edhe qesh nën buzë
«Biri im i lumtur
qenka bëre mësues».

Mbes' e vogël thotë:
«Ma lexo dhe mua,
sa xhaxha Ilian
unë asnë nuk dua!».

Të gjithë i gëzove
ti me telegram,
porse... ja, pas pak
vjen një tjetër lajm.

Vdekja jote, shok,
vetëm një rrufe
ideali yt
flakëron te ne...

Se këputet lulja
mbetet kundërmimi,
se këputet ylli
mbetet pas vegimi.

HIQMU NGA SYTË!

Si ndodhi kështu, si ndodhi, miku im?
Ku e paske ti fjalën e burrit?
Yt atë, or mik, për besnikërinë
e derdhte gjakun vu, deri te gjuri.

* * *

E ndërsa po të pyes me nerva të ngritura:
«Përse s'e mbajte fjalën?», ti po qesh,
afrohesh: «Ha! Ha! Ha!» dorën përsipër
mbi supe ngrötësish po ma hedh.

* * *

Dhjetë herë gënjeve, mua, mikun tënd
po nesër dhe Partinë mund të gënjesh...
Ç'më qesh, more, s'të ardhka hiç rëndë?
Hiqmu nga sytë e mos m'u bëj peshqesh!

* * *

Ka një mace në shpirt Biku, thonë,
një mace të vogël, qerose, makute,
që ndjenjat pareshtur ia gërryen me thonj;
për nder, kjo mace do zhdëpur me grushte,
ah, mace e keqe, mace makute!

PËR SHOKËT E FËMIJNISË


Ne mblidheshim e loznim deri vonë
netve, çdo stinë dhe çdo vit.

Për të na thirrur dilnin në ballkon,
sa shumë zëra vinin nga shtëpitë!

Ne çonim kokën lart e hapnim gojën
që qumështin e yjeve të pinim,
ne ndiqnim gjer te kodra xixëllonjat
dhe gjer nëpër pyje lakuriqin.

Tek hidhnik gurë në rrugë për matanë
flinim me bindje se s'ka burrë dheu
të jetë aq i fortë, i madh, i gjatë,
ta sosë gurin më larg se Skënderbeu.

Sikur e ndizte kodrën tejetej
sinjali «zjarr» i lojës sonë «bam-bum»,
bënim detyrën tonë edhe ne,
mësonim luftën, rendnim të pagjumë.



NINA — NANA

Shkojnë zogjtë palë-palë
që të vën' në gjumë një djalë,
thonë këngën dalngadalë.

Shkojnë zogjtë gur mbi gur
sjellin gjumë për një nur,
të rritet të bëhet burrë.

Biri i nënës faqe mollë
të rritet të shkojë në shkollë,
të marrë dije të hollë,
të rritet, të bëhet trim
të punojë me rininë,

të shkojë të mbrojë kufinë.

Merre ti në krahë, o gjumë,
merre ti e mbaje shumë
pastaj vij dhe e zgjoj unë...

SHQETËSIMI I PIKTORIT

Rrinte diku në një pllajë,
peneli i dridhej në dorë,
pse s'hidhte në letër gjigandin,
peisazhin e gjallë ky piktor?


S'i shihte vallë montatorët
që kantier më kantier fluturojnë,
që flatra s'kanë po me vrull
lartësitë përditë sfidojnë?

S'i shihte vallë saldatorët,
të vjollctat shkëndija plot zjarr,
pse s'ngjyente penelin atje,
pse letra i ngeli e bardhë?

Korpuset, uzinat, kantieret,
lëvizjen e madhe si deti
çdo gjë e shihte piktori,
peneli shtangur i mbeti...

Se s'mund të hidhte në letër
gjithë mozaikun vigan,
aq shpejt sa sytë t'i kapnin
gjer në fund të njëjtin peisazh.

Para tij kish ngjyra të tjera
një oxhak qe bërë më i lartë,
një kodër, që ishte, u zhduk,
më tej shkuan vinçat, pas pak...



NATËN MES LARTËSIVE

Hëna si një vajzë e dashuruar
faqeve ngjyrë purpuri u dha
dhe mbeti pranë oxhakut e hutuar:
«Ç'kërkoke këtu lart, or mik?» — i tha.

Oxhaku ngriti kokën rëndë-rëndë,
flokartën e afroi në kraharuar,
«E, si thua, si thua, shoqja hënë,
a mbetemi përjetë të dashuruar?»

VINÇIERI ALEKO DHE DJALI I TIJ

Ka ditë që e njoha vinçierin Aleko
me flokë kaçurrela
e sy ëndërrimtarë,
ai ngre përditë konstruksione të rënda
me një vinç të kalibrit të madh...

Ai ka një djalë të vogël një vit,
që e quajti thjesht: metalurg.
Kur të rritet, më thotë vinçieri Aleko,
do punoje patjetër këtu.

Sa herë që shokët saldojnë rrëth Alekos
e cërkat shkëlqejnë plot shkëndijim,
do që t'i puth,
aq shumë i përngjanë
me ninëzat prush të syve
të djalit të tij.

Kur shkon në shtëpi, pas punës i lodhur,
përkëdhel vogëlushin
me një ndjenjë të qashtër,
sikur përkëdhel gjithë metalurgët
e së ardhmes
me dorën e ashpër...

KUJTIM I PAHARRUAR

Shoqeve tē mia: Klemes dhe Zanës.

Dje erdhën tē fejuarit tuaj
dhe ndenjën me ju dy-tri orë,
besoj nuk folët për yje e hënë,
besoj nuk folët për zogj.

Ishin tē lodhur se vinin nga larg
po ndenjën më këmbë deri vonë;
besoj s'u mërzitën që s'gjetën një pemë
dhe një copëz me bar tē njomë.

Se tjetër romantikë ka këtu,
tjetër madhështi e mrekulli,
këto objekte prehrit tē fushës
pa ëndrra s'mund t'i shohësh kurrsesi...

Se tjetër pranverë ka këtu,
të tjera gëzime të fshehta
paçka se mungojnë lulet me erë,
lëndinëzat dhe pllajat e blerta...

Ju ecët në rrugët me pluhur
ku zhurmshëm kalonin makinat,
bisedonit, heshtnit... bënkit mënjanë
shikonit herë-herë lartësirat.

Nga takimi ku shtat hedh gjigandi
fotografi ju bëtë si kujtim,
do të lindni djem... do t'i shohin.. do thonë:
«Kur ish në aksion mami im».



VEGIME

Ditë nëntori. Në dritare
erdhi gjithë vendlindja ime,
gjithë peisazhi i saj i gjelbër.

Vajzat shkojnë mes portokallash
vjelin kokrrat rrumbullake,
siç ka mikja ime faqet.

Vajzat shkojnë mes ullinjve
Ç'veshkin kallëzat e bardha
si ball' i së shtrenjtës sime.



Ç'MË THA POEZIA E REALIZMIT SOCIALIST

«Pëlqen ti rrugën e përjetë,
rrugën ku s'ecet qetë e qetë,
rrugën që do një zemër det?

I do ti malet plot blerim,
fushat gjithë bukë e begati
dhe botën plot me lumturi?

Ty djersa shpesh të mbulon,
netve gjumi të harron
në syt e tu e nesërmja këndon.

I do ti njerëzit dhe punën,
do komunizmin përmbi glob,
ke proletarin mik e shok?

Freskin e ujërave të malit,
këngët prej zogu të përroit,
diellin flak që botën ngroh,
ijet si sumbullat prej ari
gjithçka të bukur ti e do?

Endrra me flatra ti ke shumë
ke dashuri, dëshira lumë
je luftëtar ti?..
Hyr tek unë!»

...nënaq sëb treshqet. Dësh i
dolq idomiq që minxitëm. Në
vëllat e Nënë nuk e di që

...villor si avërtipon nisjet
...dësh që dëgjat gjithë mënyra
...dësh që nated këtë dëll mënyra
...këtë dëll mënyra

NËNA NUK E DI

Në oborrin tim kam një portokalle
që e porosita të bëj kokrra shumë
dhe t'i fsheh mes gjethesh, asnje mos t'i shohë,
për atë që dua të këput ca unë.

Se e dua fshehtas studenten sykaltër
nuk e dinë shokët, nëna nuk e di,
asnjeri në botë vesh s'e ka marrë.
Rruaje sekretin portokalle ti.

MIKES

Vera doli. Lulet vanë
një këngë mbrëm' seç m'u kujtua
kush s'ka parë luleshege
të shikojë faqet e tua.

MALLI PËR FSHATIN

U zgjova herët dhe shikoj
si lind ylli i mëngjesit.
Përgjumësh lulet marrin frymë
qytetit të studentit.

Seç kam në zemër një gëzim
më duket se jam dehur.
Gruri u rrit, u rrit atje në fshat,
e shtat të lartë ka hedhur.

Seç kam në zemër një dëshirë,
mes fushës i dalldisur
të rend, të rend, të përkëdhel
gjithë grurin e harlisur.

KUSHEDI SA LULE MBININ ATË NATË...

Kishte veshur një bluzë ngjyrë vishnje
dhe një fund si qjell pranvere,
ishe bërë copëz horizonti
aq e bukur atë buzëmbrëmje.

Atë të dielë isha në aksion,
me shokët hapëm fushës një kanal.
U lodha shumë ndaj shpesh ty të thosha:
«Ecim, e dashur, pakëz më ngadalë».

Nuk pata kohë të shkoja në shtëpi
të ndërroja rroba, të lija lopatën
erdha te ti siç isha; i mban mend
rrobat tërë djersë e tërë baltë?...

Dor' e filadit gjethet përkëdhelte
dhe gjethet diçka pëshpërisnin,
diçka të ëmbël në gjuhën e tyre...
Për ne të dy... s'do mend që çoç po flisnin.

Qe prill. Nën këmbët tonë në heshtje
kushedi sa lule mbinin atë natë
si diej të vegjël shpërthenin nga toka
na buzëqëshnin në rrugën e gjatë...

NDARJE USHTARËSH

Nëntor qe atë ditë, kur nisën rrugën
që nga veriu ushtarët e liruar,
ndalonte në një kthesë, fshat a lagje
makina si një shpend krahëshkruar...

Vjeshta hidhte e hidhte gjethë
si telegrame ku shkruhej «Udha mbarë»
«Hej, na kujto me letra, mos harro»
i fliste shoku shokut, që sapo ishte ndarë.

Dhe përqafoheshin si flakët e një zjarri
që era i shpërndan, djemtë burra.
Ikte një shok... një mik... dhe në ndarje
nga dashuria sytë u ndizeshin si ura...

IDRIZ PALLËVETËTIMA

*Idriz Alidhimës që luftoi në shkurt
1878 kundër shovinistëve grek në
Sarandë.*

Në Lëkurës e në Gjashtë
pakëz përmbi det,
luftonte Idrizi
me nja shtatë a tetë.

Luftonte Idrizi,
pallëvetëtima,
tek lëvonte plumbi
porsi bobozhina.

Se donte Sarandën
të na merrte greku,
trimat gjithë sa qenë
i thirri dyfeku.

Idrizin nē ballē,
u ngritēn nē këmbē
dhe i pritēn plumbat
e grekut, me dhëmbë.

VRULLI I JETËS

Tëposhtë katarakti derdhej me zhurmë
e uji rrëmbhej e zbardhej më shumë
e uji përplasej nga shkëmbi në shkëmb
e ndihej jehona nga larg si një këngë.

Një dallgë m'u ngrit andej me vërtik,
ç'na shikon i huqar, më tha, or mik,
do të shkruash për ne? Ky është vrulli ynë,
këtë kemi ritëm, këtë kemi rimë.

Bioli na osna om s'fihibisq. Njoud II
S'fihibisq a mifliefi iaq, nimra iaq mifliefi iaq

Aj mifliefi iaq, mifliefi iaq, mifliefi iaq
S'fihibisq a mifliefi iaq, mifliefi iaq, mifliefi iaq

PO UNË S'JAM FËMIJË

Shumë mirë ne të dy do të merreshim vesh
sa ç'je e bukur tē ishe e thjeshtë.

E si ta mohoj, më pëlqenin tepër
sytë e tu det dhe flokët thekër.

Më pëlqente sa s'thuhet shtegu yt i ballit
i ngushtë, i përpjetë si shtegu i malit.

Dhe gusha jote më linte pa mend
tek ndriçonte e purpurt si gruri nën hënë.

Fëmijët e vegjël e duan një flutur
për krahët me ngjyra, për krahët e bukur.

Po unë s'jam i vogël, po unë s'jam fëmijë
të dehem nga ngjyrat, pas teje tē vij.

Ti buzët përdridhje me naze sa herë
të flisja për fshatin, pér fushën e gjerë.

Kalliri plot sheh tokën, veç yjet sheh ti.
Ç'e doja, më thuaj, të tillë bukuri?

TI RE KUR ÇELTE AGIMI

Ti re, partizan,
në pllajën e gjelbër,
t'u hapën plagët,
lulet e lirisë.

Agimi çelte,
(çelte dhe liria)
ti hodhe sytë e bukur
për nga lindja:

Një re e zezë: shamia
me vuajtjet e nënës,
një re e bardhë: shamia
me mallin e së motrës,
qielli i kuq flakë
flamur i Partisë sate.

Ti mbylle sytë,
gjithçka t'u valëvit
mbi qepalla.
Zemra jote
u la lamtumirën
me tiktiket e fundi.

Ti buzëqeshe,
agimi çeli
mbi buzëqeshjen tënde



ELEGJI PËR MARINËN NJËVJEÇARE

*Në fshatin tim gjermanët kur
dogjën dhe shkretuan kasollet,
vranë dhe një vajzë njëvje-
çare në duart e nënës, kur kjo
po i ngjitej kodrës.*

Në duart e nënës e vranë Marinën
vogëlushen e bukur si trëndelinë.

Një gjumë i përjetshëm ia puthi qerpikët,
puthi nëna bijën dhe i ra të fikët.

Puthi nëna foshnjën lindja u përflak
qielli nga dhembja po pikonte gjak.

Më shumë se dy fjalë nuk dinte Marina
e bukura, e vogla, porsi trëndelina...

Marina, e mira, e vogla një vit
ndali moshën plumbi... dhe më nuk u rrit!


Në trupin e njomë seç iu hap një plagë
nga shihej liria që ishte në prag...

SI DURON SOCIALIZMI NJERËZ TË TILLË

S'është e lehtë të shkulësh nga zemra një shok
siç shkul bar të egër kur grurin teharr,
duhet shkulur, ama, kur brenda rri kot
veç për të zhvatur, veç për të marrë.

E ke shok dhe ke thënë me të shumë gjëra,
të ka bërë ndonjëherë mirësi të mëdha,
një për një t'i di intimitetet të tëra
e je shkrirë me të në shaka...

Ta shkulësh nga zemra e ke të vështirë,
duhet luftë të bësh dhe me veten;
s'i duron socializmi njerëz të tillë,
që bëjnë kompromis me ndërgjegjjen.



SHIKOJ NË SKENË

Kush tha se u vjetërua kënga labe?

Kush tha se çiftelisë i iku koha?

A mund të thuash fushat s'kanë më lule
e bjeshkëve nuk bie më dëbora?

Sic derdhet një ujvarë prej lartësive
ashtu derdhet me iso kënga labe
dhe çiftelisë Mëhilli tek i bie
ngjan si «echo» kushtimesh nëpër male.

Shikoj në skenë studentët — djem e vajza
si marrin këngë e hedhin valle shumë,
se si më ngjajnë me ato fustanella
porsi shqiponja që çajnë nëpër furtunë.

QUTIN PERMËT

allom iisq
allom iisq
allom iisq
allom iisq

ÇELËN PEMËT

Çeli molla,
çeli dardha,
shami holla,
shami bardha.

Çeli radhë
çdo burbuqe,
një e bardhë,
një e kuqe.

Trëndafili
u mbush plot,
bukur prilli
e veshi sot.

Zogu flet
që nga foleja:
«Me shëndet
rrobat e reja».

DUHET PUNË E PUNË PËRSËRI

Doni në ëndërr të shihni
çudi, mrekullira, vërtet?
Doni të kapni kur flini
atë që ju duhet në jetë?

O! Është e pamundur, kush tha?!
Duhet punë e punë përsëri,
Mendelejevi në ëndërr e pa
zbulimin e madh në kimi.

Vite me radhë punoi ai.
Shqetësimi, ankthi e brenin
dhe bulëzat e djersës së tij
mbi fletushkat e nxira shkëlqenin.

E dëshpëruar shkruante pena
shkarravina, shifra, simbole
eh, ç'ju lodh shkencëtarit mendja
dhe letrat i dukeshin gjole...

«Ç'mundim pa frut» mendoi ai
dhe ra e fjeti një natë i veshur,
po ja pas pak, mrekulli
shkencëtari u zgjua i qeshur...

Për në kafaz pëllumbat si sulen
secili në vendin e tij.
Kështu elementet iu futën
tabelës me vrull në kuti...

Doni në ëndrra çudi,
mrekullira të shihni vërtet;
punoni gjithmonë si ai,
shkencëtari i madh, në jetë!



TREGIMI I VETERINERIT

Arsimtarja e një fshati
që e dua dhe më do,
solli nxënësit në stan,
sa çapkëne është ajo!

Më gjeti te flija në gjumë
«A ta zgjoj a ta lë rënë?».
Qengjat nisën blegërinin,
nxënësit këndonin këngë.

M'u bë gjumi më i thellë
m'u shtir vashëza në ëndërr
një muzikë, një ëmbëlsi
sikur po më bënин dhëndër.



* * *

Hoqa këpucët i bëra jastëk
hoqa kapotën e bëra dyshek.

Retë i ula, i bëra mbulesë
dhe fjeta një natë mbi barin me vesë.

Me pushkën në zemër, o ç'gjumë që bëra,
në ëndërr pashë beteja të tëra.

Ylli im i kuq, nuk e di se si
me yjet e qiellit zuri miqësi.

Në cep të një are fjetëm një natë
unë, yjet dhe pushka e gjatë.

KËSHILLAT E BABAIT

Para së gjithash
në jetë të jesh i ndershëm
dhe mos rrëshqit si ngjala
nëpër baltë.

Në jetë të jesh i rreptë me të drejtën,
të dashurosh a të urresh
me gjithë zemrën...

Zemrën ta kesh të madhe, po të pastër,
asgjë të huaj
ti mos fut në të.

Jeta është peshë dhe detyrë
djersi, përpiku,
lodhu me dëshirë.

Në një stinë me diell ti linde,
adhuroje dhe ec
nën rrezet e tij.

Sado lart që të hipësh në jetë,
erën e plisit dhe vlagën e dheut
mos e harro...

Në jetë duhet të luftosh
dhe jo të rrish i fjetur
nëpër qoshe...

Së fundi jetën ta mbushësh aq shumë,
sa djemtë e nipat
ta kenë flamar.



RETROSPEKTIVË

Mërgimi merr burrat,
djepat mbeten pa fëmijë.
Mërgimi plak nuset,
na humb djemtë e rinj.

Ç'bëjnë gjakngrirat,
nënënat zemërhelm?
Ca po presin lajme,
ca përcjellin djem.

Ikin lulëdjemtë,
nënëzezat qajnë,
me lotët e tyre
lëndinat i thajnë:

Vogëlushët natën
bukë po kërkojnë
nga çatitë prej kashte
qiellin shikojnë.

Qielli me yje
e hënë verdhacuke,
yjet copëra djathi,
hëna copë buke.

KËNGËTARËT DEKADENTË

Qajnë këngëtarët,
ulérijnë e lehin
në opera të marra
nervat çapëlehen.

Xhazi budallepsës
popujve u thotë:
«Virtyt éshtë marrëzia
dhe egërsia sot...»

C'thonë këngët e xhunglës,
këngëtarët ç'thonë?
«Kjo jetë qenka prozë,
qenka iluzion...»

Një kërcim të marrë,
narkotik kërkojnë,
puthje fluturimthi
gjithçka të harrojnë...

Hej, si fshehin kokën
pas këngës së të marrit
qejflinjtë kanibalë
të xhunglës së dollarit.

Për fundin e botës
qajnë e ulërijnë
po varri s'pret botën,
pret... borgjezinë.

VURGUT TIM


1.

Enciklopedi tē botës
fletë pér fletë
e fjalë pér fjalë,
o, sa herë kam shfletuar
që tē gjëja emrin Vurg,
po kurrkund atë s'e pashë
dhe vëllimet i pérplasja
si tē ishte faj i tyre.
«Asgjékundi s'na kan' shkruar!»
edhe zemrën po ma brente
një keqardhje si gangrenë.
Pa i lashë mënjanë librat
shkova Vurgut fshat më fshat
dhe me rrënje atë e njoha,
se shfletova me kujdes
enciklopedin' e jetës.

Më foli një plak i moçëm:
«Merr ca baltë e ca kallama
e ujëra të ndenjura,
llum, malarje, baltovinë
dhe mushkonja, dhe shushunja,
dhe korin e bretkosave
shto dhe beun dhe aganë
mbi një popull të mjeruar,
shto dhe vajet dhe urinë
që të dalë emri «Vurg».
Vurgu im i vrarë lije
me ato fshatrat e vogla,
(ah, fshatrat e gjyshërve!)
me ato kasollet qorre
në cep të kënetave.

2.

Vurg,
baltë e gatuar
me lotët e nxeh të nënave,
baltë e gatuar
me gjakun e ndezur të trimave,
po marr prej teje një grusht
dhe e puth
sikur nëpër shekuj
plagët po t'i puth.



I etur syri më bie
mbi fushat e tua të blerta,
siç binte dikur nga djepi
mbi gjirin me qumëshët të nënës.

Mbi gjoksin tënd vura veshin
dhe dëgjoj psherëtima fshatarësh
që nga thellë vitet vijnë...

3.

«Oh-oh-oo-!» qe Piloja
huzmeqar i hallevë,
«Oh-oh-o-o!» dhe i këputur
ai binte mbi parmendë.

Ai thellë psherëtinte
kur dilte hëna mbi brinjë,
çastin kur e lindi nëna
dhe dynjanë,
(haram dynjanë!)
po mallëkonte or' e çast,
kaun dhe udhën shante.

Udhëtari që kalonte
pa të mjerin tek lëngonte
iu afrua dhe e pyeti
«Ç'ke, or mik, që heq në zemër?
...Kish uri i shkreti Pilo,
ishte lodhur sa më s'ka.
Misërnike udhëtari
edhe dhallë atij i dha,
pa i ngriti sy e duar
për nga qielli
dhe parajsën sikur gjeti,
thirri Piloja
— Hej, të pastë mirë zoti!

Udhëtari qeshi hidhur
dhe i belbëzoi vetes:
«E bëra si Don Kishoti».
(Përsëri atë uria
do ta ndiqte si fantazmë!)

4.

Bistricë moj, Bistricë moj!
(Kush e njeh mitologjinë
edhe ty emrin ta di
kaq të lashtë Akeron.)
Ku është xha Karonti, moj,
ballërrudhuri varkar,
që nga njerëzit rri ndarë
pa një diell, pa një gaz
dhe dallgën tënde çante
i thinjuri dhe plaku
që udhët thellë në shpirt
i ngritën mal marazesh
dhe pjergulla trishtimi.

— O xha Karont, dua t'i them,
që nga kjo botë te tjetra
ti njerëzit përcolle.
Sa foshnja çove ti matanë,
sa çove të parritur
që fjalën «nënë» dhe «baba»
s'e patën thënë akoma?
Sa gra e burra të sëmurë,
që vdiqën nga malarja,
ti përmatanë hodhe?
Sa thasë mbushe nëpër lumë,
sa thasë me të mbytur

kur dallga ashpërsohej?
Si vallë varka s'tu vithis,
si nuk u lodhe
e si s'të ranë
lopatat që nga duart?
Eh, xha Karont, o plak Karont
shumë punë ke pasur
ti në Vurg.

E moj Bistrica syshkëndi,
emrin e lashtë tej e flake
bashkë me Karontin plak
edhe varkën misterioze.

Ngadalë shkon mes fushave
orizin e vadit
vadit pemët rrënëjë më rrënëjë
vreshitat edhe portokallet.
Pa hyn vrulltas në shtëpi
e dritat i ndez në mbrëmje
ve në punë frigoriferë
lavatriçet me qindra...

5.

I etur më bie syri
mbi Vurgun fushëblertë
dhe nga zemra vjen një këngë
kënga e vurgarëve:



«Ku çakalli kish fole
është kthyer në bahçe,
tek kish gjemba edhe pralle,
atje ku s'prodhohej fare

është mbjellur portokalle,
portokalle dhe limona
me këto krahët tonë,
e ardhmja është jona».

Era e Partisë që frysni,
era e pranverave
lulëzoi një vend të tërë.
Në prehër të viteve
agimet vijnë me vesë,
dielli dyfish i ngrohtë,
derdhen nxënës nëpër shkolla
plot dëshirë e hare,
nisen njerëzit si bleta
të punojnë fushave.
«Këmishtaj ne do ta bëjmë
Vurgun, o shoku Enver!»
Buzagaze vijnë mbrëmjet
me këngë të vegjëlish,
vijnë dhe nënët shamibardha,
edhe vajzat aq të çiltra
e me djemtë gjithë vrulle
kthejnë në pragjet e shtëpive
ngjyrëpurpur, ngjyrëzjarr.

6.

Mbi tridhjetë herë bleruan
edhe bukën sollën arat
qëkurse na ikën trimat,
«Lule djemtë e nënave»,
qëkur ra një vesë e ngrohtë
mbi barin e pllajave.

(S'ishte vesë, ishte gjak,
gjaku i të rënëve,
që i hidheshin armikut
sikur kishin nga dy kokë
edhe njëra nuk u dhimbej,
grykave...)

Hidheshin një vrapi në vitet
e së ardhmes dhe këpusnin
nga një bisk dhe në zemrën,
që ish vyshkur nga malarja
e nga brengat, ata Vurgut
ia shartonin.

S'qenë bisqe, ishin shpresat,
qenë thirrje për t'u ngritur
për liri.


Qenë këngë
që i merrte me violinë
komisari Lefter Talo,
qenë gaz e ishin drithë,
ishin fjalët e Partisë.

7.

Jeshilojnë misrat fushës
me rrënjet nëpër gëzhoja.
Mbi bunkerët e tunelet
gruri hedh vallen e bukës,
shkojnë vajzat grupe-grupe
që nga kodrat gjer në ara
venë për të shirë grurë,
që nga arat gjer në kodra
lulediell venë të korrin.

O moj lulja e trëndelinës,
që rritesh kodrinave,
rinia hapi tarraca
ta solli pataten fqinjë
ruaj gjethin mos i thahet,
ruaje se mos mërdhin,
trëndelinë moj.

Erdhën djemtë nga qyteti
në fshatrat e prindërve
mekanikë dhe shofera,
muratorë, këngëtarë...



8.

Me shtëpinë time ngjitur
është një tjetër, ku një mbesë
e lodh gjyshen veç me pyetje
netve:

«Ku ish pylli, ku këneta,
ku u mbyt xha Kiçoja,
kishte halle shumë ai?
Si i ra nga duart bebja
asaj nëne që po ngjitej

për në kodër? Plumbi
ia rrëzoi, gjyshja ime? Më e madhe
qe se unë ajo bebe?
Po pse na e dogji fshatin
ky gjermani, gjyshja ime?
Kush e vrau komisarin,
që i qepe yllin ti?»
Atëherë gjyshja zbret në vite
herë buzëqesh
e herë trishtohet.

9.

Vurg!
Baltë e gatuar
me lotët e nxeh të nënave,
baltë e gatuar
me gjakun e ndezur të trimave!
Një grusht prej teje po marr
dhe e puth
sikur puth nëpër shekuj
plagët e tua.

Vurg,

i etur syri më bie
mbi fushat e tua të blerta
siç binte dikur nga djepi
mbi gjirin e nënës sime

Vurg,

këngë e blertë e së ardhmes.